

VENDIM
Nr. 283, datë 4.5.2023

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI NGA MINISTRIA E MBROJTJES TEK
BASHKIA LEZHË TË NJË PJESE TË PRONËS NR. 983, ME EMËRTIM
“REPARTI USHTARAK NR. 4010”, ME VENDNDODHJE NË GJADËR, LEZHË,
PJESË E PASURISË NR. 420/1, ZONA KADASTRALE 1716, DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 515, DATË
18.7.2003, TË NDRYSHUAR, DHE NR. 414, DATË 11.7.2007, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, shkronja “gj”, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi nga Ministria e Mbrojtjes tek Bashkia Lezhë të një pjese të pronës nr. 983, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 4010”, me vendndodhje në Gjadër, Lezhë, pjesë e pasurisë nr. 420/1, zona kadastrale 1716, me sipërfaqe 5 000 (pesë mijë) m², e llojit “truall”, dhe sipërfaqe 37.6 (tridhjetë e shtatë pikë gjashtë) m², e llojit “ndërtesë”, sipas formularit të inventarizimit dhe planrilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, me qëllim për ta përdorur për realizimin e nevojave të saj për varreza publike.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 414, datë 11.7.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Lezhë të qarkut të Lezhës”, të ndryshuar.

3. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, sipërfaqja e përcaktuar në pikën 1 hiqet nga prona me nr. rendor 983.

4. Bashkisë Lezhë i ndalohet ndryshimi i destinacionit të përdorimit të pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, tjetërsimi dhe dhënia në përdorim të tretëve.

5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Bashkia Lezhë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.


ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE
Pjese e Prones Nr.983 "Rep. Usht. 4010", Gjader, Lezhe
(Sip. dhe objekti per kalim ne pronesi nga MM tek Bashkia Lezhe)

PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPERISE/MM FA DATE: 20.04.2023 QELIMI: TRANSFERIM

VENDNDODHJA
BASHKIA: LEZHE DVASHK/ZVASHK: LEZHE ZONA KADASTRALE: 1716 NUMRI PASURISE: 420/1 INDEX HARTE: K-34-76-(84-C)
TE DHENAT E PASURISE
LLOJI PASURISE: TRUALL SIP.PASURISE= 1162802 m2 SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT=14848.45 m2 NUMRI KATEVE: NUMRI PEMEVE:

X 466599 Y 4638663 KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE X 467086 Y 4638663



X 466599 Y 4638340 SH 1:2500 X 467086 Y 4638340

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	VERI			420/1 (95/11, 194)		
2	LINDJE			97/53		
3	JUG			97/54		
4	PERENDIM			95/7		

REALIZOI PER IGJIU
SPECIALISTI: RAMIZ HAXHIU
NENSHKRIMI
KONFIRMOI PER IGJIU
DREJTORI: March, TEUTA KANXHERI
NENSHKRIMI / VULA
TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T, Z, O
Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash;
PERCAKTIMI KUFIRIT: P, HK
Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;
SHENIME TE VECANTA:
PRONARI: SHTET MM (FORCAT AJRORE)
MIRATOHEJ
KOMANDANTI I FORCES AJRORE
GJENERAL BRIGADE YLLI PULAJ

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale